



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE**

Nr. i Dokumentit: 24.2.1-2017-08

**RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË PANELIT ZGJEDHOR
PËR ANKESA DHE PARASHTRESA PËR VITIN E PËRFUNDUAR
MË 31 DHJETOR 2017**

Prishtinë, prill 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, e cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Udhëheqësi i ekipit Sabile Musa dhe anëtare e ekipit Mazlumsha Sejfadini, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Faruk Rrahmani.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	10
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	14
5 Qeverisja e mirë.....	15
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	17
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake.....	20
Shtojca III: Letërkonfirmimi	21

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 13/02/2018.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm


Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Përgjigja e Kryesuesit të Sekretariatit

Kryesuesi i Sekretariatit ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP). Ne kemi analizuar veprimtarinë e PZAP-së se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) të PZAP-së merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar

Ne kemi audituar PFV-të e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalesjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Nr. 04/L-116, Nr. 04/L-194 dhe Ligjin Nr. 05/L-063) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Kryesuesi i Sekretariatit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Nr. 04/L-116, Nr. 04/L-194 dhe Ligjin Nr. 05/L-063).

Kryesuesi i Panelit dhe Kryesuesi i Sekretariatit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të PZAP-së.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

PZAP kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Nr. 04/L-116, Nr. 04/L-194 dhe Ligjin Nr. 05/L-063);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Planin përfundimtar të Prokurimit;
- Raportet për obligimet e papaguara; dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).

Në kontekst të PFV-ve, ishte bërë një gabim te neni 16 Raportet për të arkëtueshmet pasi që të arkëtueshmet e viteve paraprake në vlerë prej 22,999€ nuk ishin prezantuar te kolona e vitit 2017 por vetëm ishin shpalosur. Megjithatë PZAP i ka korrigjuar PFV-të në të cilat ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur.

Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në MF, konsiderohet e plotë dhe e saktë në të gjitha aspektet materiale.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime lidhur me PFV-të.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me MFK-në, pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi shpenzimet dhe të hyrat në përgjithësi janë të përshtatshme dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive, por kontrollet mbi fushën e menaxhimit të pasurive kërkojnë përmirësim të mëtejshëm në lidhje me zhvlerësimin e pasurive nën 1,000€.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	217,160	295,909	257,473	190,810	170,089
Granti i Qeverisë -Buxheti	217,160	295,909	257,473	190,810	170,089

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 78,749€. Me rishikim buxheti ishte rritur për 90,509€, kurse me vendim të Qeverisë² buxheti ishte reduktuar për 17,760€. Rritja e buxhetit ka ndodhë si rezultat i kërkesës së PZAP-së për pagesën e shtesës mujore për stafin aktual dhe rekrutimit të stafit me kontrata për shërbime të veçanta, për periudhën gjatë proceseve zgjedhore.

Në vitin 2017, PZAP ka shpenzuar 87% të buxhetit final me një ulje sipas përqindjes prej 12% krahasuar me vitin 2016. Megjithatë, duhet theksuar se krahasimi me vitin paraprak në aspektin e përqindjes nuk na jep ndonjë informatë shumë relevante nga fakti që në vitin 2017 buxheti ishte më i madh si rezultat i organizimit të zgjedhjeve nacionale dhe lokale.

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

² Vendimi i Qeverisë nr. 10/19 i datës 15.12.2017

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	217,160	295,909	257,473	190,810	170,089
Pagat dhe Mëditjet	130,727	189,326	162,324	127,486	123,492
Mallrat dhe Shërbimet	73,613	93,763	84,591	58,407	41,442
Shërbimet komunale	7,820	7,820	7,018	4,917	5,155
Investimet Kapitale	5,000	5,000	3,540	-	-

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Buxheti për shpenzime kapitale ishte shpenzuar 71%. PZAP ka planifikuar një projekt për vitin aktual dhe i njëjti është realizuar sipas sasisë së paraparë në planin e prokurimit, por me një kosto më të ulët (oferta fituese); dhe
- Buxheti për paga dhe mëditje si dhe mallra dhe shërbime nuk ishte realizuar në tërësi sepse buxheti final i ndarë ishte më i lartë se sa nevojat. Kjo si pasojë e pamundësisë që të planifikohet saktë puna shtesë e nevojshme gjatë proceseve zgjedhore.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.2 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga PZAP në 2017 ishin në vlerë 459,245€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga gjobat e shqiptuara për partitë politike.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	2017 Pranimet	2016 Pranimet	2015 Pranimet
Të hyrat vetjake	459,245	1,624	71,855
Totali	459,245	1,624	71,855

PZAP realizon të hyra nga shqiptimi i gjobave për subjektet politike në rastet kur ato kanë bërë shkelje ligjore gjatë procesit zgjedhor. Shqiptimi i gjobave vjen pas ankesave të bëra nga subjektet politike ose individ tjerë si dhe konstatimit nga paneli zgjedhor se shkelja ka ndodhur.

Të hyrat e arkëtuara transferohen në Buxhetin e Kosovës (BK). Totali i të hyrave të arkëtuara reflekton një rritje dukshëm më të lartë krahasuar me vitet paraprake.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.3 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga Ministria e Administratës Publike (MAP) dhe MF-së. Sipas shënimeve të SIMFK-së, buxheti për kategorinë e Pagave dhe Mëditjeve ishte 189,326€, ndërsa realizimi i shpenzimeve ishte 162,324€. Numri i planifikuar i stafit ishte 20, derisa numri aktual në dhjetor të vitit 2017 ishte 19. Numri aktual i stafit përfshinë 10 anëtarët e Panelit me pagë sekondare ndërsa pjesa tjetër është staf i sekretariatit me pagë primare.

Për periudhën gjatë procesit zgjedhor është aplikuar shtesa mujore prej 60% e pagës bazë për të gjithë stafin, ndërsa për stafin e shërbyesve civil është aplikuar edhe shujta në vlerë 60€. Këto shtesa janë është aplikuar me vendim të qeverisë.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.4 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime përfshirë shërbimet komunale në vitin 2017 ishte 101,583€. Prej tyre ishin shpenzuar 91,610€. Ato kanë të bëjnë me: furnizim me kompjuterë, shpenzimet të udhëtimit, shpenzime për telefoni mobile, si dhe kompensime për stafin me kontrata për shërbime të veçanta, të angazhuar gjatë procesit zgjedhor. Numri i stafit me kontratë për shërbime të veçanta ishte 12.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 5,000€. Prej tyre në 2017 ishin shpenzuar 3,540€. Ato kanë të bëjnë me blerjen e një makine fotokopjuese me procedura të rregullta të prokurimit.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.6 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Vlera neto e pasurive të PZAP-së e shpalosur në PFV ishte 44,254€. Prej tyre vlera e pasurive kapitale (mbi 1,000€) ishte 4,946€, pasuri jokapitale (nën 1,000€) ishin 15,276€, dhe vlera e stoqeve ishte 24,033€.

Ne kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit dhe mënyra e mbajtjes së evidencave është në pajtueshmëri me kërkesat e rregullës së MF-Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, procesin e inventarizimit, zhvlerësimin dhe ekzistencën fizike të pasurive.

Çështja 1 - Sistemi "e-pasuria" me mangësi në kalkulimin e zhvlerësimit

E gjetura Përkundër që PZAP ka komunikuar me MAP-in për funksionim të rregullt të sistemit e-pasuria, ne kemi vërejtur se nuk ishte duke u kalkuluar si duhet zhvlerësimi për të gjitha pasuritë nën 1,000€. Në katër raste³ me vlerë totale prej 1,703€, për pasuri të blera në vitin 2010 nuk ishte kalkuluar fare zhvlerësimi. Vlera fillestare dhe vlera neto e pasurisë ishte e njëjtë. Këto pasuri duhet të figurojnë me vlerën zero.

Rreziku Mos zhvlerësimi i pasurisë sipas normave të rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive ka ndikuar me mbivlerësim të pasurive dhe prezantim jo të saktë të tyre në PFV.

Rekomandimi 1 Kryesuesi i Sekretariatit duhet të shtoj kontrollin në menaxhimin e pasurive, duke siguruar që zhvlerësimi i pasurive bëhet në pajtim me rregulloren në fuqi, si dhe raportim të saktë të vlerës së tyre në PFV.

3.7 Të arkëtueshmet

Vlera e llogarive të arkëtueshme në fund të vitit 2017 ishte 186,549€, prej tyre 163,550€ ishin gjoba të shqiptuara ndaj subjekteve politike gjatë zgjedhjeve lokale të mbajtura më 22 tetor 2017, kurse vlera prej 22,999€ janë gjoba të bartura nga vitet paraprake. Siç vërehet pjesa kryesore e llogarive të arkëtueshme rrjedh nga tremujori i fundit të vitit 2017. Në fillim të vitit 2018 ka inkasim në vlerë prej 33,450€ ndërsa pjesa tjetër është në proces.

Mekanizmat që po i aplikon PZAP për inkasimin e gjobave po tregohen mjaft efikase. Një prej tyre është që nëse subjektet politike nuk i paguajnë obligimet (gjobat) atëherë PZAP e njofton Komisionin Qendror Zgjedhor (KQZ) me qëllim që nga fondet që ju ndahen subjekteve politike që kanë ulëse në parlament nga KQZ të paguhen (transferohen) obligimet në llogari të PZAP-së. Në rastet kur KQZ nuk e aplikon njoftimin nga PZAP, atëherë hapi tjetër është inkasimi përmes përmbaruesit privat.

³ Comjuter Fujitsu Esprimo E3521 me vlerë 548€; Notebook Fujitsu LB A530 me vlerë 565€; Camera Codak E asy Share M575 me vlerë 175€; dhe Printer Lexmark E260DN me vlerë 414.50€.

Një problem më i theksuar janë të arkëtueshmet e bartura nga vitet 2010-2014 në vlerë prej 22,999€ të cilat mund të jenë edhe për subjekte politike të shuara. Megjithatë, këto lëndë janë dërguar te përmbaruesi privat.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.8 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 1,161€, prej tyre 1,086€ ishin obligime të papaguara nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, ndërsa 75€ për shërbime komunale. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2018. Obligimet e papaguara kanë mbetur për shkak se faturat janë pranuar me vonesë.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2016 ka rezultuar me tri rekomandime. PZAP kishte përgatitur planin e veprimtimit ku kishte paraqitur afatet dhe mënyrën se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, dy rekomandime janë zbatuar ndërsa një ishte në proces të zbatimit (rekomandimi lidhur me zhvlerësimin e pasurive nën 1,000€). Rekomandimi i bartur nga viti 2015 për hartimin e regjistrimit të rrezikut ishte zbatuar në vitin 2017.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmer veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK-së nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i pyetësorëve të vet-vlerësimit që plotësohen nga të gjitha organizatat, të cilat në fund të vitit i dorëzohen MF-së.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

PZAP në përgjithësi ka kontrolle të mira në raport me obligimet ligjore të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli ka dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit.

PZAP ka zbatuar pjesën më të madhe të rekomandimeve si dhe ka përgatitur regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat, duke identifikuar të gjitha rreziqet domethënëse që mund të kenë ndikim tek organizata në lidhje me arritjen e objektivave të saj. Megjithatë deri në fund të auditimit tonë nuk është vërejtur se është bërë vlerësimi, monitorimi dhe azhurnimi i regjistrit të rreziqeve.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Sipas UA Nr. 23/2009 për themelimin dhe funksionimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB), PZAP nuk i plotëson kriteret për themelimin e kësaj njësie.

Rekomandime

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtja e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se volumi i madh i punëve gjatë proceseve zgjedhore ka ndikuar në vonesa në raportimin e aktiviteteve.

Çështja 2 - Dobësi në menaxhimin e rrezikut

- E gjetura** Sipas rregullave të MFK-së, PZAP ka krijuar procedura formale dhe të dokumentuara të vlerësimit dhe menaxhimit të rrezikut. Megjithatë, edhe pse regjistri i rreziqeve është hartuar, ai nuk menaxhohet në mënyrë aktive për sa i përket azhurnimit dhe sigurimit se janë ndërmarrë veprime për të parandaluar dhe zbutur rreziqet.
- Rreziku** Mungesa e menaxhimit efektiv dhe gjithëpërfshirës të rrezikut do të dobësoj cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve nëse çështjet e brendshme dhe të jashtme që ndikojnë në këtë, nuk adresohen në kohën e duhur. Kjo për shkak se veprimet pro aktive të nevojshme për të parandaluar ose evituar ndikimin e çështjeve të tilla nuk do të ndërmerren në mënyrë të planifikuar dhe sistematike.
- Rekomandimi 2** Kryesuesi i Sekretariatit duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut nëpër sektorët përkatës dhe të sigurojë monitorim efektiv dhe raportim tremujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
2.5.1. Menaxhimi i rrezikut	Kryesuesi i Sekretariatit duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për hartimin e listës për menaxhimin e rrezikut tek pozitat përkatëse.	Po		
Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
2.2 Pyetësi i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së	Kryesuesi i Panelit duhet të sigurojë se në vazhdimësi rishikohet plotësimi i pyetësorit të vet-vlerësimit, përfshirë edhe listën e rreziqeve për të adresuar fushat me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm efikas për ta konfirmuar saktësinë e pyetësorit si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.	Po		
3.1.2 Pagat dhe mëditjet	Kryesuesi i Panelit, duhet të sigurojë se vendimet e marra për kompensimet për punë jashtë orarit të jenë në përputhshmëri me legjislacionin përkatës, në mënyrë që mos të tejkalohen limitet e përcaktuara.	Po		
3.2 Pasuritë	Kryesuesi i Panelit duhet të iniciojë dhe kërkojë një rishikim të sistemit e-pasuria nga Ministria e Administratës Publike për të konfirmuar që ky sistem përmbush kushtet për të siguruar se regjistrimi dhe menaxhimi i pasurisë bëhet në përputhje me kërkesat e rregullores nr. 02/2013.		Janë marrë masa, megjithatë ende ka raste ku nuk është aplikuar zhvlerësimi për pasuritë nën 1,000€.	

Shtojca III: Letërkonfirmimi



Republika e Kosovës – Republika Kosovo
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

Republika e Kosovës – Republika Kosovo NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE NATIONAL AUDIT OFFICE			
12.04.2018			
Nr. Dokumenti	Nr. Klasifikim	Nr. Klasifikim	Nr. Klasifikim
05	401	511	1

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Mul Desku, Kryesues i sekretariatit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Data: 12 Prill 2018, Prishtinë,

